



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2023



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më 31.10.2023

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fatmir Qaka, EVSB

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Fidaim Fazliu-KBI

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Fadil Guri-Zyra për Kthim dhe Komunitete

Përfajqsuesi i FSK

Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore

Lorik Ramaj-FSK

Zahir Doda-Drejtoria e Arsimit

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Trajtimi i ankesave të qytetarëve mbi sigurinë përgjithshme
- 4.Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së KKSB për vitin 2024
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Në pikën e dytë të rendit të ditës për periudhën në mes dy takimeve Kryetari fjaloi dhe Komandantit të Policisë z. Halim Shehut.

Halim Shehu – Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë .

Gjithësej në këtë periudhë kohore kemi 68 raste .Vjedhje 9 raste , vjedhje të rënda 4 , vjedhje në tentativë - 2 raste , vjedhje e një veture e cila më vonë është gjetë , vjedhje në pyje - 4 raste , dëmtim prone - 6 raste , kanosje - 4 raste , sulme - një rast , dhunë në familje - 6 raste që është shqetësuese rritja e kësaj dukurie , 2 raste kemi ngacmim, lëndim të lehtë trupor kemi 6 raste , lëndime të rënda trupore - 2 raste, falsifikim i parasë kemi 1 një rast, lëndim aksidental në vendë pune kemi 1 rast, dëmtim i instalimeve publike - një rast, posedim i lëndëve narkotike - dy raste, armëmbajtje pa leje - 6 raste, pranim i gjërave të vjedhura - një rast, vdekje e dyshuar - një rast në fshatin Dubravë , pengim i personit zyrtarë në kryerjen e detyrës - një rast, incident zjarri - një rast, keqpërdorim i kartelës bankare - 1 rast, grabitje kemi një rast ku tek të dyshuarit janë gjetur një sasi e konsiderueshme e armëve dhe 3 persona janë arrestuar si të dyshuar në këtë rast , keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare kemi një rast .

Pra thënë në përgjithësi situata e sigurisë në komunën tonë është e mirë dhe në këtë drejtim ne jemi Komuna më e qetë krahasuar me Komunat tjera .

Gjendja më e rënduar është në Pyje e sidomos në pjesën e Parkut Nacional ku kohëve të fundit është bërë një shkatërrim masiv i qëllimshëm dhe me këtë rast është duke u marrë Agjensioni i Pyjeve .

Gjendja e Trafikut në përgjithësi nuk është edhe aq keq , siguria nëpër shkollë falë bashkëpunimit të mirë që kemi është në nivel të duhur .

Menduh Krasniqi – Dua të ngris një shqetësim rreth një dukurie jo të mirë që po e bëjnë disa persona me vetura në parkingun e Kompleksit të Varrezave të Dëshmorëve të cilët tubohen dhe zhvillojnë atraksione me veturat e tyre .

Halim Shehu – Jemi në dijeni të kësaj dukurie dhe ne kemi vepruar duke i kapur disa persona të cilët u janë nënshtruar procedurave ligjore .

Fidaim Fazliu – Deshta të ngrisë një shqetësim rreth një rasti të ndodhur në mars të këtij viti ku disa të rinjë të cilët rritet fetare i bëjnë të veqanta kanë krijuar probleme në Xhaminë e Qytetit duke shkuar edhe në kërcënime për stafin e Bashkësisë Islame .

Është kohë e gjatë që ka ndodhur ky rast dhe nuk kemi pasur mundësi të takohemi ngase ju në këtë kohë keni qenë jashtë shtetit e poashtu edhe unë kam munguar në dy takime .

Edhe pse nuk keni qenë këtu ne si Institucion Fetarë kemi njoftuar Policinë por që nuk jamë i kënaqur me mënyrën si kanë vepruar Policia në lidhje me këtë rast.

Si çdo Institucion edhe Xhamia e ka një orarë ku besimtarët kryejnë ritet e tyre .

Ky grup i të rinjëve 15 ditë radhazi në këtë kohë nuk kanë respektuar orarin dhe përmes sjelljeve të tyre të pahishme kanë penguar stafin e Bashkësisë Islame që të kryejnë detyrën e vet , andaj kërkojmë nga ju si Komandant i Policisë të bashkëpunoni me ne dhe të mirren masa ndaj atyre që pengojnë punën e stafit të Bashkësisë Islame .

Halim Shehu – Jam i njoftuar lidhur me këtë rast dhe në bazë të informacioneve që kam Policia në rastin e marrjes së informacionit ka vepruar menjëherë .

Ne jemi për bashkëpunim dhe çdo herë që paraqitet ndonjë rast të na njoftoni .

Ky grupë i të rinjëve është i njohur për ne, janë nën vëzhgim por që nuk kanë përkrahje nga qytetarët .

Deri më tani nuk ka kurrfarë indikacioni se janë të organizuar për prishje të rendit dhe qetësisë publike .

Vedat Dema – U përmend në raportin e juaj se janë 6 raste të dhunës në familje dhe mua po më intereson çka keni ndërmarrë në lidhje me këto raste .

Halim Shehu – Ne rastet i trajtojmë në bazë të kompetencave që i kemi , i drejtojmë tek organet e Drejtësisë të cilët i shqyrtojnë rastet dhe veprohet me masa mbrojtëse ndaj viktimave por që sfida për ne është se viktimat nuk po e respektojnë këtë masë mbrojtëse duke i thyer rregullat e kësaj mase dhe duke mos qëndruar në shtëpi.

3.Trajtimi i ankesave të qytetarëve mbi sigurinë përgjithshme

Në kuadër të Komunës e kemi edhe një komision që bënë hapjen e kutive të ankesave dhe në bazë të raportit të tyre nuk kemi asnjë ankesë që ndërlidhet me qështjen e sigurisë publike .

Ka individë që fizikisht kontaktojnë me ne dhe shfaqin ndonjë shqetësim por që anëso me shkrim që ju ka drejtuar ndonjë Drejtorie nuk kemi .

Halim Shehu – Ne në Stacionin e Policisë kemi një sistem tjetër për parashtrim të ankesave . Zakonisht bëhet përmes postës elektronike dhe telefonatave , ku bëhet regjistrimi dhe trajtimi i ankesave

4. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së KKSBB për vitin 2024

Kryetari – Propozoj që i njëjti komision të mirret me hartimin e planit të punës së KKSBB – së për vitin 2024 e që ka qenë në këtë përbërje :Zahir Doda , Elmihane Malsiu , dhe Fadil Guri .

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e KKSBB-së dhe ky komision në mbledhjen e radhës do ta prezentoj këtë plan i cili në seancën e parë të Kuvendit Komunal të vitit 2024 do të del për miratim .

5. Të ndryshme

Zahir Doda – Deshta të e bëjë një falenderim për Policinë me të cilët kemi një bashkëpunim shumë të mirë sa i përket aktiviteteve të përbashkëta që kanë me shkollat por që e kam edhe një kërkesë që të ndërmarrim masa ndaj disa grupeve jashtë shkollore që shpesh po e pengojnë procesin mësimor.

Halim Shehu – Falë bashkëpunimit të mirë që kemi me institucionet arsimore neve na është mundësuar zhvillimi i disa aktiviteteve nëpër shkollë që lidhen me tema të ndryshme e që janë të nevojshme për nxënësit .

Sa për njoftim, për ne si Institucione, është një OJQ që në bashkëpunim me Departamentin e Emergjencave kanë shprehur gadishmërinë në trajnimin e zyrtarëve Komunal në lidhje me aparatet për fikjen e zjarrit . Është mirë që të kontaktohen ngase edhe Komuna ka nevojë për trajnime të tilla. Trajnimet janë falas dhe duhet të shfrytëzohet kjo mundësi .

Deshta të ngris si shqetësim mosfunksionimin e kamerave të sigurisë e cila temë ishte trajtuar edhe në takimin e fundit por që sot unë duhet të raportoj në nivel regjional në lidhje me hapat që janë ndërmarr me këto kamera .

Në bazë të informatave që kam të gjitha Komunat e kanë zgjidhë këtë çështje dhe sugjeroj që të kontaktohet ndonjë Komunë dhe të shikohet se si kanë mundur ata të e zgjidhin këtë problem .

Kryetari – Asetet janë të juaja dhe po më intereson të dija a është diskutuar në takimet regjionale në lidhje me mirëmbajtjen prej Komune . Ligjërisht unë dua të jem në rregull . Do ua bëjë edhe një shkresë MPB-së që së paku të marrë një vendim që Komuna mund të udhëheqë procedurat për mirëmbajtje të këtyre kamerave dhe ne shumë shpejtë mund ta realizojmë një projekt të tillë .

Rekomandimet

1. Të mirren masa ndaj atyre që pengojnë ushtrimin e detyrës zyrtare .
2. Të mirren masa ndaj grupeve jasht shkollore që pengojnë procesin mësimorë .
3. Të bëhet një zgjidhje e shpejt për funksionimin e kamerave të sigurisë në hapsirat publike .
4. Bashkpunim edhe më i mirë ndërinstitutional në pengimin e dukurive negative në shoqëri .

Kryesoi

Kryetari – Besim Ilazi



Procesëmbajtës

Fatmir Qaka

A blue ink signature of Fatmir Qaka, written over a horizontal line.